



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:228455

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05451881

C.nr.344/17

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me autorizim N.K, kundër të paditurit S.K, nga fshati .., Komuna e Vushtrrisë, të cilin e përfaqëson me autorizim Av.B.H, nga Vushtrria, me objekt kontesti Kthim i mjeteve financiare nga pasurimi i pabazë, me vlerë të kontestit 6,247.15 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës 11.03.2024, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe të autorizuarit të të paditurit, me datë 14.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri S.K, nga fshati .., Komuna e Vushtrrisë, që paditëses në emër të fitimit të pa bazë, t’ia kthej shumën e mjeteve prej 6,247.15 € (gjashtë mijë e dyqind e katërdhjetë e shtatë euro e pesëmbëdhjetë cent), me kamatë prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit.

II. DETYROHET paditësja Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të paditurit S.K, t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi shumën prej 104 euro, si dhe për përfaqësim në një seancë shumën prej 135 euro, përkatësisht shumën totale prej 239.00 euro, në afat prej 15 ditësh nga

pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, përmes të autorizuarës-Avokatura Shtetërore, me datë 03.08.2017, ka paraqitur padi pranë kësaj gjykate, kundër të paditurit S.K, nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, përmes të cilës ka kërkuar që të detyrohet i padituri S.K që paditëses, në emër të fitimit të pabazë, t’ia kthej shumën e mjeteve prej 6,247.15 € (gjashtë mijë e dyqind e katërdhjetë e shtatë euro e pesëmbëdhjetë cent), me kamatë prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit. Ka theksuar se i padituri ka aplikuar dhe ka përfituar nga Masa 101 të MBPZHR-së 2014-2020 Sektori i Perimeve dhe me datë 06.06.2014 është lidhur Kontrata nr.16/2014 për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural. Po ashtu ka theksuar se pas kontrollës se realizuar në terren me datë 16.02.2017, me qëllim të verifikimit të kushteve të pranueshmërisë së grandeve, ku gjatë kontrollës është konstatuar se i padituri S.K nuk i posedon pajisjet e fituara për pemëtari- mekanizëm për nxjerrje të patateve dy rendëshe dhe piatoret, duke konsideruar se investimi publik nuk është përdorur sipas Planit të Biznesit. Andaj, bazuar në dispozitën e nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-098 Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe dispozitën e nenit 38 A të Ligjit nr. 04/l-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, paditësja gjykatës i ka propozuar që të aprovohet kërkesëpadija si e bazuar, po ashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore aq sa krijohen deri në përfundim të procedurës.

Përgjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditëses ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadiisë, duke theksuar se paditësja pas realizimi të kontrollës së datës 28.06.2017 kanë vërejtur se i padituri nuk iu ka përmbajtur kushteve për mbështetje financiare për të cilën ka pranuar mjetet. Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë është dashur që ta ndërprejë kontratën për shkak të parregullsive të gjetura nga super- kontrolla, për këtë arsye si në kërkesën e saj paditësja ka kërkuar kthimin e mjeteve në vlerë prej 6,247.15 euro. Po ashtu ka theksuar se nga administrimi i provave e sidomos nga raporti i kontrollës, është vërtetuar se i padituri nuk iu ka përmbajtur kushteve të kontratës, edhe pse ka fituar grante apo mbështetje financiare nga Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë, dhe meqenëse nuk iu ka përmbajtur kushteve të kontratës duhet t’i kthejë mjetet ashtu siç e parasheh kontrata në rast të shkeljeve eventuale.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurit S.K, av. B.H në vazhdimësi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, me pretendimin se i padituri e ka përmbushur në tërësi kontratën dhe se nuk ka asnjë obligim ndaj paditëses. Po ashtu ka theksuar se nuk është kontestues fakti se paditësja dhe i padituri kanë lidhur kontratë për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural nr.16/2014 e datës 03.06.2014, dhe vlera e pranueshme e projektit të financuar është 10.400 euro, ndërsa Agjencia e ka ndihmuar të paditurin me 65%. Me vendim për mbështetje nga programi i zhvillimit rural, të paditurin agjencia e ka përkrahur me mjete publike në vlerë prej 6,247.15 euro, për mekanizma bujqësor. Sipas kontratës, i padituri ka blerë mekanizma bujqësor dhe në momentin e kontrollës të inspektorëve të i padituri i kanë gjetur këto mjete: spërkatësja, freza, makina për mbjelljen e patateve dy rendëshe dhe kultivatori me rezervar, plehu artificial. Gjatë kontrollit ka munguar makina për nxjerrjen e patates dy rendëshe dhe piatorja, këto mjete kanë qenë në teren, përkatësisht në arat e veta dhe për këtë arsye inspektorët në raportin e tyre kanë konstatuar se i padituri nuk i posedon këto makina.

Në fjalën përfundimtare ka theksuar se makinat të cilat nuk janë gjetur gjatë kontrollit nuk janë shitur, nuk janë huazuar dhe nuk janë tjetërsuar nga i padituri, ky fakt gjatë kësaj seance me asnjë provë nuk është vërtetuar, nga këto arsye gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet pasi që i padituri në tërësi i ka përmbushur obligimet nga kontrata. Po ashtu, i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi shumë prej 104 euro dhe për një seancë shumë prej 135 euro.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka administruar të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe atë: *Formulari për aplikim i datës 17.03.2014, njoftimi i MBPZHR- Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, i datës 29.05.2014, Kontrata për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural nr.16/2014 e përpiluar me datë 03.06.2014, ndërsa e protokolluar me datë 06.06.2014, vendimi i MBPZHR- Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ref. AZHB 07/4/2014 i datës 09.12.2014, Raporti nga kontrolli në teren i datës 16.02.2017, i realizuar dhe i përpiluar nga Inspektorët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, kërkesa e MBPZHR- Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, e datës 28.06.2017, kërkesa për kthimin e mjeteve e MBPZHR- Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, fatura numër 218/14 e datës 21.08.2014, formulari mbi urdhër-transferin i datës 29.08.2017, fatura 14- SHV 01- MHF-1204 dhe dëftesa e pagesës në Bankën TEB nr. 00000517 e datës 29.08.2014.*

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në

dispozitat nga nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, duhet të refuzohet si e pa bazuar.

Nuk është kontestues fakti se palët ndërgjyqëse më datë 06.06.2014 kanë lidhur kontratë për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural, përkatësisht për blerjen e mjeteve bujqësore dhe vlera e përkrahjes nga paditësja sipas kësaj kontrate ishte 65%, apo në shumën prej 6,247.15 euro.

Nuk është kontestues as nga paditësja fakti se i padituri S.K kishte blerë mjetet bujqësore si: kultivator me depozitor dhe pijator, me çmimin prej 2,500 euro, si dhe nxjerrëse e patateve ROLMET me nr. serik 4136 si dhe kardan i nxjerrëses, me çmimin prej 3,600 euro, gjë që vërtetohet nga faturat e ofruara si prova nga i padituri.

Kontestuese ishte fakti se i padituri a iu ka përmbytur planit të biznesit dhe kontratës për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural, të datës 06.06.2014, pasi që paditësja ka pretenduar se pas kontrollës në teren të realizuar me datë 16.02.2017, është konstatuar se i padituri S.K nuk i posedon makineritë bujqësore si: makinë nxjerrëse të patates dy rendëshe si dhe pijator, andaj edhe i njëjti ka përfitur pa bazë juridike dhe duhet t'ia kthej paditëses shumën prej 6,247.15 euro, sepse nuk iu ka përmbytur kontratës së datës 06.06.2014, për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural dhe se i padituri ka vepruar në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-098 Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe dispozitën e nenit 38 A të Ligjit nr. 04/l-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

Nga Raporti i kontrollit në teren i datës 16.02.2017, i realizuar dhe i përpiluar nga Inspektorët e Agjensisë për Zhvillimin e Bujqësisë, gjykata ka gjetur se i padituri gjatë kontrollit i ka pasur në posedim mjetet bujqësore si: spërkatësja, freza, makina mbjellëse e patates dy rendëshe, kultivatori me rezervar dhe plehu artificial. Ndërsa i padituri nuk i ka pasur në posedim makinën nxjerrëse të patates dy rendëshe si dhe pijatoren. Po ashtu, nga ky raport shihet se sipas deklaramit të të paditurit, pijatori është tek një i afërm (dhëndrri), ndërsa makina nxjerrëse e patateve është në huazim tek kompania SH.P.K P..

Nga faturat e dorëzuara nga i padituri si fatura numër 218/14 e datës 21.08.2014, formulari mbi urdhër-transferin i datës 29.08.2017, fatura 14-SHV01-MHF-1204 dhe dëftesa e pagesës në

Bankën TEB nr. 00000517 e datës 29.08.2014, vërtetohet se i padituri i ka blerë mjetet bujqësore sipas obligimit që ka pasur me kontratën e lidhur me paditësen.

Me dispozitat e nenit 194 të Ligjit Nr. 04/l-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, përcaktohen rregullat e përgjithshme të pasurimit të pa bazë, ku përcaktohet se 1. *Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur.* 2. *Fjala pasurim po ashtu përfshinë përvetësimin e fitimit përmes shërbimeve.* 3. *Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket.*

Me dispozitën e nenit 9 par.2 të Ligjit Nr. 03/L-098 Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, përcaktohet se *“Përfituesit duhet t’i përdorin fondet në përputhje me qëllimin për të cilin ato janë dhënë”*. Ndërsa në nenin 7 par.3 të Ligjit nr. 04/l-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, përcaktohet se *“Në rast të keqpërdorimit nga paragrafi 2 i ligjit në fuqi, përfituesi, duhet kthyer fondet sipas dispozitave të këtij ligji”*, ndërsa në nenin 38 A, të këtij plotësim-ndryshimi të ligjit, përcaktohet se par.1 *“Ndëshkimet në rast të parregullsive, bëhen si vijon”*: pika 1.1 *“E tërë shuma e përkrahjes kthehet sipas ligjit”*.

Kontrata e datës 06.06.2014, për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurit, në nenin 5 par.2 përcaktonte se *“Në qoftë se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë vëren se investimi publik i financiar nuk është përdorur sipas qëllimit të tyre, planit teknik të projektit dhe planit të biznesit, ose është shitur ose dhënë me qira, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë ka të drejtë dhe obligim që të kërkojë kthimin e shpenzimeve të bëra.”*

Bazuar në faktet e vërtetuara më lartë dhe dispozitat e lartcekura ligjore, gjykata erdhi në përfundim se i padituri S.K, fillimisht nuk ka përfutur pa bazë juridike marr parasysh faktin se i njëjti ka aplikuar për përkrahje financiare nga paditësja bazuar në legjislacionin në fuqi dhe pas përzgjedhjes ka lidhur kontratë me paditësen për financimin e projekteve investuese, andaj edhe nuk qëndron pretendimi i parë i paditëses se i padituri është pasuruar pa bazë juridike.

Gjithashtu nuk qëndron pretendimi i paditëses se i padituri nuk iu ka përmbajtur kontratës për financimin e projekteve investuese dhe se i njëjti ka vepruar në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-098 Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe dispozitën e nenit 38 A të Ligjit nr. 04/l-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural,

pasi që mjetet e përfituara nga paditësja, i ka shfrytëzuar për blerjen e mjeteve bujqësore, në mënyrën dhe qëllimin për të cilin janë dhënë. Kjo vërtetohet edhe nga faturat të cilat i padituri ia ka ofruar gjykatës si prova, në të cilat shihet se i ka blerë mjetet bujqësore. Prandaj, nga të gjitha këto rezulton fakti se i padituri nuk i ka shitur e as nuk i ka dhënë me qira mjetet bujqësore, por vetëm se në momentin kur është realizuar kontrolli nuk i ka pasur në posedim.

Përfundimisht, bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e paditëses, se e padituri ka bërë shkelje të dispozitave të kontratës për financimin e projekteve investuese dhe se i njëjti ka vepruar në kundërshtim me neni 9 të Ligjit Nr. 03/L-098 Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe dispozitën e nenit 38 A të Ligjit nr. 04/l-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, andaj edhe kërkesëpadia e paditëses u refuzua si e pabazuar.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e mbështeti në nenin 452, par.1 të LPK-së,

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e duke u bazuar në nenin 143.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.344/17, më datë 14.03.2024

G j y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.